



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Konfirmohet obligimi i zbatimit të vendimeve të CEFTA-s dhe protokolleve të saj.
2. Zbatimi, nga pika 1. e këtij Vendimi, nënkupton çdo veprim ligjor apo administrativ që duhet ndërmarrë për realizimin e zbatimit.
3. Obligohen të gjitha ministratë, agjencitë dhe organet përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi, sipas veprimtarisë së tyre.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti të mbledhjes së 277-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve 275 dhe 276 Elektronike /Korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/280  
Datë: 19.12.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M   P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi për krijimin e së drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit "Linja ajrore 110 kv, Parku me Erë - Zatriq 1&2", zonat kadastrale: Rahovec, Zatriq dhe Drenoc, Komuna e Rahovecit, investim nga kompania "EV WIND PARK SHPK", sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit, që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi, apo cilëndo pjesë të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkuar dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ndërmarrja Publike dhe Qendrore KOSTT dhe Investitori "EV - WIND PARK Sh. P. K".

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Lu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M   P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish-shoqërore të Ndërmarrjes Shoqërore, Industria e Mobileve "Përparimi", dhe të atyre private, për nevoja të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, zona kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi, apo cilësdo pjesë të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit I hapësiror dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 9, 10, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M   P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Kycjes së Vitisë në Autoudhën "Arbën Xhaferi", Prishtinë - Hani i Flezit", zonat kadastrale: Gërlicë dhe Komogllavë, Komuna Ferizaj, dhe zona kadastrale Begracë, Komuna e Kaçanikut, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi, apo cilësdo pjesë të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkuar dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Rrugës Tranzit në Klinë, nga N9 deri në R - 104" Klinë - Gurakoc, zonat kadastrale: Klinë, Klinafç, Dollc dhe Dresnik, Komuna e Klinës, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe obligimeve të tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit, do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/280  
Datë: 19.12.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i Rugës Nacionale M25 Prishtinë - Podujevë", zonat kadastrale: Bërnice e Epërme, Bardhosh, Trudë, Lebanë, Prugovc, Besi, Vranidoll dhe Teneshdoll, Komuna e Prishtinës, dhe zonat kadastrale: Lupç i Poshtëm, Shakovicë, Lluzhan dhe Lluggë, Komuna e Podujevës, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit, që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe obligimeve të tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit, do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, bazuar në nenin 7 të Rregullores Nr. 22/2024 për Ekspertët, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen Raporti i tretë i Punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, Lista e sistemeve të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore dhe Lista e pozitave të punës të lidhura me sistemet përkatëse.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**

*Komisioni për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike -  
Komisija za procenu državnih informacionih i komunikacionih sistema od strateškog značaja -  
Commission for the assessment of state information and communication systems of strategic importance*

**RAPORT I TRETË I PUNES SË KOMISIONIT PËR VLERESIMIN E SISTEMEVE  
SHTETËRORE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT ME RËNDËSI STRATEGJIKE**

Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 13.11.2024, me vendimin nr. 10/230, ka themeluar komisionin për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike.

Komisioni nga data e themelimit ka shqyrtuar dhe rishqyrtuar kërkesat e pranuar nga Zyrtarët Kryesorë Administrativ për vlerësimin e sistemeve dhe ekspertëve në bazë të RREGULLORES (QRK) Nr. 22/2024 PËR EKSPERTËT.

Më datë 23 nëntor 2024, Komisioni ka harmonizuar pyetësin për aplikim të institucioneve për sisteme me rëndësi strategjike me Rregulloren e re 22/2024 për Ekspertët dhe e ka dërguar te institucionet që kanë bërë kërkesë për vlerësim të sistemeve dhe pozitave nga data e themelimit të Komisionit më 13.11.2024.

Të gjitha kërkesat e institucioneve janë shqyrtuar me kujdes dhe për shumicën e tyre janë kërkuar informata shtesë nga institucionet në mënyrë që të bëhet një vlerësim real i sistemeve dhe ekspertëve që menaxhojnë, administrojnë, zhvillojnë dhe mirëmbajnë këto sisteme.

*Metodologjia e realizimit të punës së komisionit është bazuar në parimet e mëposhtme:*

- Puna është bazuar në Ligjin për Paga në Sektorin Publik, Nr. 08-L-196, Neni 44 – Shtojcat e Ligjit, Shtojca 14.4 për Ekspertët dhe Rregullorja Nr.22/2024 për Ekspertët
- Çdo institucion mban përgjegjësi për saktësinë e informacionit të dërguar
- Pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara, një sistem i informacionit dhe komunikimit që i përket kategorisë "sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike" është analizuar për pozitën që kanë përgjegjësi në menaxhimin, koordinimin dhe administrimin e atyre sistemeve.

Komisioni ka vlerësuar sistemet në tabelën e mëposhtme si sisteme me rëndësi strategjike, duke i kategorizuar ato në përputhje me rregullat dhe kriteret e përcaktuara për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, Komisioni ka shqyrtuar kërkesat të cilat janë pranuar nga data e themelimit të komisionit deri në fund të muajit janar 2025, ndërsa kërkesat tjera janë në proces të shqyrtimit dhe vlerësimit.

Gjithashtu, me qëllim të zbatimit të vendimeve përfundimtare gjyqësore, Komisioni i rekomandon qeverisë përfshirjen e sistemeve të AKSP-së, si dhe dy pozita të PK-së dhe katër pozita të AKSP-së në listën e sistemeve të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike



shtetërore, si dhe listën e pozitive të punës të lidhura me sistemet përkatëse, konkretisht sipas detyrimeve në aktgjykimin A.nr.909/2024 dhe Aktvendimin CP.Nr.16/24.

Tabela 1 – Rekomandimet për përfshirjen e sistemeve në listën e Sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike

| Nr. | Emri i Institucionit                  | Emri i sistemit të rrjetit dhe informacionit                                                              |
|-----|---------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Universiteti i Prishtinës             | Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS)                                                     |
| 2   | Kuvendi i Kosovës                     | Sistemi i Integruar Digjital i sallës Seancave Plenare të Kuvendit të Kosovës                             |
| 3   | Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit     | Sistemi i Certifikatave dhe Pagesave Elektronike (SCPE)                                                   |
|     |                                       | Sistemi i Kontrollit dhe Menaxhimit të Gjurmueshmërisë së Ushqimit (FCMS)                                 |
| 4   | Zyra e Kryeministrit                  | Qendra e të dhënave                                                                                       |
|     |                                       | e-Cabinet                                                                                                 |
|     |                                       | Sistemi Elektronik-Portali shtetëror i Gazetës Zyrtare                                                    |
| 5   | Shërbimi Korrektues i Kosovës         | Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Rasteve të Burgosurve (SIMB)                                           |
|     |                                       | Sistemi i Videoseancave Online për të Burgosurit                                                          |
| 6   | Ministria e Ekonomisë                 | Platforma për Monitorim Verifikim dhe Raportim MVP                                                        |
|     |                                       | Regjistri Kombëtar i Performancës Energjetike të Ndërtesave - RKPEN                                       |
| 7   | Ministria për Komunitete dhe Kthim    | Sistemi i Menaxhimit të Rasteve për Personat e Zhvendosur                                                 |
| 8   | Akademia e Kosovës për Siguri Publike | Bazat e të Dhënave të AKSP-së                                                                             |
|     |                                       | Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) për Fakultetin e Sigurisë Publike                                  |
|     |                                       | Sistemi i mësimi në distance E-LEARNING (MOODLE)                                                          |
|     |                                       | Rrjetat Kompjuterike                                                                                      |
|     |                                       | Sistemi i Serverëve dhe platformat Hyper – V                                                              |
|     |                                       | Sistemi Digjital për Menaxhimin e Bibliotekës                                                             |
|     |                                       | Sistemi i Telefonisë VOIP (ASTERISK)                                                                      |
|     |                                       | Sistemi i vëzhgimit të hapësirave të AKSP-së me IP kamera dhe sistemi i pajisjeve të kontrollit të qasjes |
|     |                                       | Sistemi i sigurisë përmes TWO FACTOR AUTHENTICATION apo qasjes me smart Kartela                           |

Komisioni gjithashtu rekomandon që pozitat në tabelën e mëposhtme të shtohen/korrigjohen në listën e ekspertëve për secilin institucion:



Tabela 2 – Rekomandimet për plotësim/ ndryshim të listës së pozitave të ekspertëve

| Nr.                      | Institucioni                                   | Nr. pozitive | Emërtimi i pozitës                                                              | Numri i pozitave të propozuara | Kategorizimi i pozitës | Shënim                                                                                                                                                                                               |
|--------------------------|------------------------------------------------|--------------|---------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.                       | Universiteti i Prishtinës<br>"Hasan Prishtina" | 1            | Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme                                       | 1                              | B5                     | <b>PLOTËSIM/NDRYSHIM:</b><br>Përmirësim i emërimit të pozitës nga "Administratori i TI-së për sisteme" në "Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme"                                                |
|                          |                                                | 2            | Administratori i rrjetit korrigjohet në Administrator i Lartë i TI-së për Rrjet | 1                              | B5                     | <b>PLOTËSIM/NDRYSHIM:</b><br>Përmirësim i emërimit të pozitës nga "Administratori i Rrjetit" në "Administrator i Lartë i TI-së për Rrjet"                                                            |
|                          |                                                | 3            | Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme                                       | 1                              | B5                     | Shtohet në listën e ekspertëve                                                                                                                                                                       |
|                          |                                                | 4            | Administrator i TI-së për Sisteme                                               | 15                             | B6                     | Shtohet në listën e ekspertëve                                                                                                                                                                       |
|                          |                                                | 5            | Specialiste e TI-së për ID kartela                                              | 1                              | B7                     | Shtohet në listën e ekspertëve                                                                                                                                                                       |
| Totali i pozitave në UP: |                                                | 5            | Nr. pozitive të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitive të propozuara  | 2+17=19                        |                        | <b>Pozitat e shtuara në listë:</b><br>Pozitat 1 dhe 2 janë pozita që janë aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr.23/165 të dt. 12/10/2023. Ndryshohet vetëm emërtimi, ndërsa 17 pozita i shtohen listës. |
| 2                        | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës    | 1            | Zyrtar i lartë i TI                                                             | 1                              | B6                     | Shtohet në listën e ekspertëve                                                                                                                                                                       |

|                           |                          |   |                                                                                                |       |                                                                                                                          |                                                                      |
|---------------------------|--------------------------|---|------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|
| Totali i pozitave në MPJD |                          | 1 | Nr. pozitive të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitive të propozuara                 | 3+1=4 |                                                                                                                          |                                                                      |
| 3                         | Ministria e Shëndetësisë | 1 | Drejtor Departamentit të Sistemit të Informacioneve Shëndetësore                               | 1     | B2                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 2 | Udhëheqës i Divizionit të Planifikimit Strategjik të SISH                                      | 1     | B3                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 3 | Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrje të SISH-it                                               | 1     | B3                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 4 | Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softuerike                                     | 1     | B4                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 5 | Zyrtar i Lartë i TI-së për Sisteme                                                             | 1     | B5                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 6 | Zyrtar i Lartë i TI-së për Siguri                                                              | 1     | B4                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 7 | Administrator i TI-së për Sisteme                                                              | 1     | B6                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 8 | Zyrtar i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave                                                  | 5     | B5                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 9 | Zyrtar i Lartë i TI-së për Sisteme Softuerike                                                  | 1     | B4                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
| Totali i pozitave në MSh: |                          | 9 | Nr. pozitive të aprovuara                                                                      | 13    | Largohen të gjitha pozitat e aprovuara me vendimet e mëhershme të Qeverisë dhe shtohen pozitat e listuara në këtë tabelë |                                                                      |
| 4                         | Kuvendi i Kosovës        | 1 | Koordinator i Njësisë së Përkrahjes se Sistemit Audio/Video dhe Sistemit Elektronik të Votimit | 1     | B3                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 2 | Zyrtar për përkrahje audio/video dhe sistem elektronik të votimit                              | 1     | B6                                                                                                                       | Shtohet në listën e ekspertëve                                       |
|                           |                          | 3 | Koordinator i Njësisë për Teknologji Informative                                               | 1     | B3                                                                                                                       | PLOTËSIM/NDRYSHIM:<br>Korrigjohet klasa për këtë pozitë nga B6 në B3 |



| Totali i Kuvendit të Kosovës |                                   | 3 | Nr. pozitave të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitave të propozuara | 3+2+2=7  | Pozitat e shtuara në listë:<br>Pozita 3 është pozitë që është aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 09/216 të dt. 14/08/2024. Ndryshohet klasa për këtë pozitë, ndërsa 2 pozita i shtohen listës. |                                |
|------------------------------|-----------------------------------|---|--------------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|
| 5                            | Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit | 1 | Udhëheqës i Divizionit të TI-së                                                | 1        | B3                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                              |                                   | 2 | Zyrtare në Divizionin e TI-së                                                  | 1        | B7                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                              |                                   | 3 | Zyrtar për Administrimin e TI-së                                               | 1        | B7                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
| Totali i pozitave ne AUV     |                                   | 3 | Nr. pozitave të aprovuara                                                      | 3        |                                                                                                                                                                                                 |                                |
| 6                            | Zyra e Kryeministrit              | 1 | Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative                              | 1        | B3                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                              |                                   | 2 | Specialist i mbështetjes për TI                                                | 1        | B7                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                              |                                   | 3 | Administrator i Rrjetit                                                        | 1        | B6                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                              |                                   | 4 | Administrator i Sistemit                                                       | 1        | B6                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                              |                                   | 5 | Administrator i bazës së të dhënave                                            | 1        | B6                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                              |                                   | 6 | Zyrtar i Lartë për web faqen (Sistemin Elektronik) të Gazetës Zyrtare          | 1        | B6                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
| Totali i pozitave në ZKM:    |                                   | 6 | Nr. pozitave të aprovuara                                                      | 6        |                                                                                                                                                                                                 |                                |
| 7                            | Këshilli Prokurorial i Kosovës    | 1 | Zyrtar i teknologjisë informative                                              | 11       | B7                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
| Totali i pozitave në KPK:    |                                   | 1 | Nr. pozitave të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitave të propozuara | 10+11=21 |                                                                                                                                                                                                 |                                |
| 8                            | Ministria e Ekonomisë             | 1 | Zyrtar i Lartë i Teknologjisë Informative                                      | 1        | B5                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                              |                                   | 2 | Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative                            | 1        | B7                                                                                                                                                                                              | Shtohet në listën e ekspertëve |

|                                  |                                                         |   |                                                                                                    |          |    |                                |
|----------------------------------|---------------------------------------------------------|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|----|--------------------------------|
|                                  |                                                         | 3 | Zyrtar i Lartë për të Dhëna                                                                        | 1        | B7 | Shtohet në listën e ekspertëve |
| <b>Totali i pozitave në ME:</b>  |                                                         | 3 | <b>Nr. pozitive të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitive të propozuara</b>              | 3+3=6    |    |                                |
| <b>9</b>                         | <b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>                  | 1 | Udhëheqës i Divizionit për Siguri Kibernetike                                                      | 1        | B3 | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                                  |                                                         | 2 | Zyrtar i Lartë për Politika të Sigurisë Kibernetike                                                | 1        | B4 | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                                  |                                                         | 3 | Inxhinier i Lartë i Sigurisë Kibernetike                                                           | 1        | B4 | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                                  |                                                         | 4 | Udhëheqës i Divizionit për Administrimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore | 1        | B3 | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                                  |                                                         | 5 | Zyrtar i Lartë për Administrimin e SIMBNj-së                                                       | 1        | B5 | Shtohet në listën e ekspertëve |
| <b>Totali i pozitave në MPB:</b> |                                                         | 6 | Zyrtar i Lartë për Administrimin e Sistemeve të Informatave të Burimeve Njerëzore                  | 1        | B7 | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                                  |                                                         | 7 | Zyrtar i Lartë për Administrimin e Sistemeve të Burimeve Njerëzore                                 | 1        | B7 | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                                  |                                                         | 7 | <b>Nr. pozitive të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitive të propozuara</b>              | 7+3+7=17 |    |                                |
|                                  |                                                         | 1 | Drejtor i Departamentit të Sistemit për Prokurim Elektronik                                        | 1        | B2 | Shtohet në listën e ekspertëve |
|                                  |                                                         | 2 | Udhëheqës i Divizionit të TI-se për Administrim të Sistemit të Prokurimit Elektronik               | 1        | B3 | Shtohet në listën e ekspertëve |
| <b>10</b>                        | <b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP)</b> | 3 | Udhëheqës i Divizionit për procese të prokurimit elektronik                                        | 1        | B3 | Shtohet në listën e ekspertëve |



|                                   |   |                                                                                                  |        |    |                                                                     |
|-----------------------------------|---|--------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|----|---------------------------------------------------------------------|
|                                   | 4 | Specialist i mbështetjes, për sistemet shtetërore të informacionit e komunikimit                 | 2      | B7 | Shtohet në listën e ekspertëve                                      |
|                                   | 5 | Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softuerike B4 Administrator i Lartë i Sistemeve  | 1      | B4 | Shtohet në listën e ekspertëve                                      |
|                                   | 6 | Administrator i lartë i sistemeve                                                                | 1      | B4 | Shtohet në listën e ekspertëve                                      |
| <b>Totali i pozitave në KRPP:</b> | 6 | <b>Nr. pozitive të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitive të propozuara</b>            | 3+7=10 |    |                                                                     |
| 11                                | 1 | Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative                                               | 1      | B3 | Shtohet në listën e ekspertëve                                      |
|                                   | 2 | Administrator i Lartë i TI për Baza të të Dhënash                                                | 1      | B5 | Shtohet në listën e ekspertëve                                      |
|                                   | 3 | Administrator i Lartë i TI për Sisteme                                                           | 1      | B5 | Shtohet në listën e ekspertëve                                      |
|                                   | 4 | Zyrtar i Lartë i TI                                                                              | 5      | B7 | Shtohet në listën e ekspertëve                                      |
| <b>Totali i pozitave në SHKK:</b> | 4 | <b>Nr. i pozitive të aprovuara</b>                                                               | 8      |    |                                                                     |
| 12                                | 1 | Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve | 1      | B3 | Shtohet në listën e ekspertëve                                      |
| <b>Totali i pozitave në MKK:</b>  | 1 | <b>Nr. pozitive të aprovuara</b>                                                                 | 1      |    |                                                                     |
| 13                                | 1 | Shef i Sektorit për Përgjime Ligjore                                                             | 1      | B3 | <b>POZITË E SHTUAR NË LISTË:</b><br>Sipas Aktgjykimit A.nr.909/2024 |
|                                   | 2 | Shef i Njësisë për Përgjime Ligjore                                                              | 1      | B4 | <b>POZITË E SHTUAR NË LISTË:</b><br>Sipas Aktgjykimit A.nr.909/2024 |

|                            |                                              |   |                                                                                               |           |                                                                                                               |
|----------------------------|----------------------------------------------|---|-----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Totali i pozitave në PK:   |                                              | 2 | Nr. pozitave të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitave të propozuara me këtë raport | 59+6+2=67 | Pozitat e shtuara në listë:<br>Pozitat 1 dhe 2 duhet të shtohen në listë sipas Aktgjykimit A.nr.909/2024      |
| 14                         | Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) | 1 | Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative                                            | 1         | POZITË E SHTUAR NË LISTË:<br>Sipas Aktvendimit CP.Nr.16/24                                                    |
|                            |                                              | 2 | Administrator i Bazave të të Dhënave                                                          | 1         | POZITË E SHTUAR NË LISTË:<br>Sipas Aktvendimit CP.Nr.16/24                                                    |
|                            |                                              | 3 | Zyrtar i teknologjisë Informative                                                             | 2         | POZITË E SHTUAR NË LISTË:<br>Sipas Aktvendimit CP.Nr.16/24                                                    |
| Totali i pozitave në AKSP: |                                              | 3 | Nr. pozitave të aprovuara me vendimet e mëhershme + nr. pozitave të propozuara me këtë raport | 0+4=4     | Pozitat e shtuara në listë:<br>Pozitat nën 1, 2 dhe 3 duhet të shtohen në listë Sipas Aktvendimit CP.Nr.16/24 |





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 28 të Ligjit Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, nenin 17, paragrafi 1, të Rregullores Nr. 11/2024 për Procedurat e Verifikimit e të Sigurisë së Personelit dhe Procedurat e Ankesës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 05/220, i datës 11 shtator 2024, për themelimin e Komisionit të Ankesave për personat që u është refuzuar Certifikata e Sigurisë së Personelit, si në vijim:
  - 1.1. Pikës 1.1 të Vendimit të cekur më lart i shtohet fjala: kryesues.
  - 1.2. Pika 1.2 e Vendimit të cekur më lart zëvendësohet si në vijim: Kapiten Isa Gashi, Shef i Sektorit të Informacionit të Klasifikuar dhe Verifikimit të Sigurisë, përfaqësues i Policisë së Kosovës, zëvendësohet me Arben Paçarizi, zëvendëskryesues.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/220, të datës 11 shtator 2024.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, i themeluar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/130, të datës 22.02.2023, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 14/169, të datës 27.10.2023, Vendimin Nr. 19/218, të datës 28.08.2024, Vendimin Nr. 12/249, të datës 26.02.2025, dhe Vendimin Nr. 01/268, të datës 22.08.2025, i vazhdohet mandati deri me datën 20.03.2026.
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 11/280

Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneks A (Kursimet)

| BLOK U KODLES              | ORGANIZATA                                            | PROGRAM               | KAT   | KATEGORIA                                | SHEMA        |
|----------------------------|-------------------------------------------------------|-----------------------|-------|------------------------------------------|--------------|
| 10/305/42200/20/15/09/0443 | MINISTRIA E MEDICISE, PLANIFIKIME KAFENOR ORE REFRASE | MOETIA I AUTOTRAKTEVE | 15090 | REJISA NACIOIALE PRITINJE-GRAN-KORRIGJUL | 2,019,785.00 |
|                            |                                                       |                       |       |                                          |              |
| TOTAL -INVESTIME KAPITALE  |                                                       |                       |       |                                          | 2,019,785.00 |
|                            |                                                       |                       |       |                                          |              |
| TOTAL-KURSIME              |                                                       |                       |       |                                          | 2,019,785.00 |



## Aneks B (Ndarjet)

| BLOKU KODUES                    | ORGANIZATA                                   | PROGRAMI                               | KAT   | KATEGORIA                 | SUMUA        |
|---------------------------------|----------------------------------------------|----------------------------------------|-------|---------------------------|--------------|
| 10/201/2930/20000000/0112       | MINISTRIA E FINANCAVE, FUNES DHE TRANSFEREVE | PROGRAMI I RIMEKEMBAJES EKONOMIKE (MF) | 20    | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 1,284,190.00 |
| TOTAL-SUBVENCIONE DHE TRANSFERE |                                              |                                        |       |                           | 1,284,190.00 |
| 10/206/11306/30/19380/0750      | MINISTRIA E SHËNDETËSISË                     | ADMINISTRATA ORDORE - MSH              | 19380 | RANOGJIMI I DEPOS         | 735,595.00   |
| TOTAL-INVESTIME KAPITALE        |                                              |                                        |       |                           | 735,595.00   |
| TOTAL-NDARJE                    |                                              |                                        |       |                           | 2,019,785.00 |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31, të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49, të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62, të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90, të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99, të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140, të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159, të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178, të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178, të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 01/241, të datës 27.12.2024, dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 02/270, të datës 07.10.2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 2,297,290.00 € (dy milionë e dyqind e nëntëdhjeteshtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë euro), për zbatimin e masave 3.6, 4.5 dhe 3.8 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nënprogramet si në vijim:
  - 2.1. Në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", ndahen mjete në shumë prej 110,000€ (njëqind e dhjetë mijë eurosh), për zbatimin e Vendimit Nr. 03/270 të datës 07.10.2025;
  - 2.2. Në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", ndahen mjete në shumë prej 537,290€ (pesëqind e tridhjeteshtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë euro), për zbatimin e Vendimit Nr. 02/263 të datës 27.06.2025.
  - 2.3. Në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", ndahen mjete në shumë prej 1,650,000.00€ (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë euro), për zbatimin e Vendimit Nr. 02/270 të datës 07.10.2025.
3. Mjetet, sipas këtij Vendimi, transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.



5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 paragrafit 1, të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99 të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178 i datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178 i datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 01/241 i datës 27.12.2024, dhe Vendimin e Qeverisë Nr.09/270 të datës 07.10.2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Ndryshohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr.09/270 të datës 07.10.2025 dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:
  - 1.1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 1,500,000€ (një milion e pesëqind mijë euro) për subvencionimin e teksteve dhe materialeve mësimore.
2. Mjetet e lira buxhetore prej 1,000,000€ (një milion euro) që rezultojnë të lira nga ndryshimi dhe plotësimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi shfuqizohen, dhe konsiderohen si të pa alokuara dhe të pashpenzuara, si dhe mbesin si pjesë e ndarjes buxhetore fillestare.
3. Pjesët e mbetura të Vendimit të Qeverisë Nr.09/270 të datës 07.10.2025 mbesin të pandryshuara dhe të pa afektuara nga ky Vendim.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.



5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/280

Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 2, neni 12 të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 15/158 të datës 29.11.2013**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Aneksi 1, i përcaktuar në pikën 1. të Vendimit të Qeverisë Nr. 15/158, të datës 29.11.2013, në raport me regjimin e vizave ndaj qytetarëve të Republikës së Fixhit, për të cilët vendoset regjimi i vizave për hyrje në Republikën e Kosovës.
2. Pikat e tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 15/158, të datës 29.11.2013, mbesin të pandryshuara.
3. Obligohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

## Aneks I.

Lista që i referohet paragrafit 1 të këtij vendimi

|                              |                                          |                              |
|------------------------------|------------------------------------------|------------------------------|
| - Antigua dhe Barbuda        | - Malavi                                 | - Rep. e Irlandës*           |
| - Argjentina                 | - Malejzia                               | - Rep. e Islandës*           |
| - Australia                  | - Maldives                               | - Rep. e Italisë*            |
| - Bahamas                    | - Mali I Zi                              | - Rep. e Kilit               |
| - Bahrein                    | - Mbr. e Arabisë Saudite                 | - Rep. e Kostarikës          |
| - Barbados                   | - Mbr. e Bashkuar dhe<br>Irlanda Veriore | - Rep. e Koresë Jugore       |
| - Belize                     | - Mbr. E Belgjikës*                      | - Rep. e Kroacisë*           |
| - Brunei Darussalam          | - Mbr. E Danimarkës*                     | - Rep. e Maqedonisë          |
| - Bulgaria*                  | - Mbr. Jordanisë                         | - Rep. e Qipros*             |
| - Domenika                   | - Mbr. Holandës*                         | - Rep. e San Marinos*        |
| - D. i Madh i Luksemburgut*  | - Mbr. Norvegjisë*                       | - Rep. e Serbisë             |
| - El Salvador                | - Mbr. Spanjës*                          | - Rep. e Sllovakisë*         |
| - Em. e Bashkuar Arabe       | - Mbr. Suedisë*                          | - Rep. e Sllovenisë*         |
| - Federata e Mikronezisë     | - Meksika                                | - Rep. e Shqipërisë          |
| - Fed. E Bosnjë Hercegovinës | - Mauritius                              | - Rep. e Turqisë             |
| - Fixhi                      | - Nauru                                  | - Rumania*                   |
| - Hungaria*                  | - Nikaragua                              | - Shën Kitts dhe Nevis       |
| - Grenada                    | - Omani                                  | - Shën Lucia                 |
| - Guajana                    | - Paku                                   | - Shën Vinsent dhe Grenadina |
| - Guatemala                  | - Panama                                 | - Samoa                      |
| - Greqia*                    | - Papa Guinea e Re                       | - Sao Tome dhe Príncipe      |
| - Ishujt Marshall            | - Paraguaji                              | - Selia e Shenjtë*           |
| - Ishujt Sejšel              | - Polonia*                               | - Singapor                   |
| - Ishujt Solomon             | - Portugalia*                            | - Svazilandi                 |
| - Japonia                    | - Principata e Andorës                   | - Shteti i Izraelit          |
| - Katari                     | - Princ. e Lihtenshtajnit*               | - Shtetet e B. të Amerikës   |
| - Kanadaja                   | - Principata e Maltës*                   | - Timori Lindor              |
| - Kiribati                   | - Principata e Monakos*                  | - Tonga                      |
| - Kolumbia                   | - Rep. e Austrisë*                       | - Trinidad dhe Tobago        |
| - Konfederata e Zvicerës*    | - Rep. e Estonisë*                       | - Tuvalu                     |
| - Kuvaiti                    | - Rep. e Çekisë                          | - Uruguaji                   |
| - Latvia*                    | - Rep. e Finlandës*                      | - Venezuela                  |
| - Lesoto                     | - Rep. e Francës*                        | - Vanuatu                    |
| - Lituania*                  | - Rep. Fed. e Brazilit                   |                              |
|                              | - Rep. Fed. e Gjermanisë*                |                              |
| - Zelandue Re                | - Rep. e Hondurasit                      |                              |

\*Shtetet anëtare të BE-së dhe shtete anëtare të zones Schengen.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 15/280  
Datë: 19.12.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Profesional për përzgjedhjen e artistit/grupit të artistëve për ngritjen e "Memorialit për Familjen Jashari dhe Epopenë e UÇK-së", në Bashkinë Hora e Arbëreshëve, në Itali, donacion ky i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Komunitetin Arbëresh në Itali.
2. Komisioni profesional ka këtë përbërje:
  - 2.1. Arlinda Hajrullahu, kryesuese;
  - 2.2. Durim Abdullahu, anëtar;
  - 2.3. Elvis Hoxha, anëtar;
  - 2.4. Hajrullah Lushtaku, anëtar;
  - 2.5. Sali Shoshi, anëtar.
3. Komisioni profesional si në paragrafin një (1) dhe dy (2) ka përgjegjësinë që:
  - 3.1. Të hartojë programin dhe kriteret profesionale të memorialit;
  - 3.2. Të organizojë dhe të koordinojë procesin për përzgjedhjen e artistit/grupit të artistëve, që do të propozojnë veprën artistike memoriale;
  - 3.3. Të monitorojë zbatimin e projektit të hartimit të veprës artistike memoriale; dhe
  - 3.4. Të përcaktojë vlerën financiare të veprës artistike memoriale.
4. Vendimet e Komisionit profesional merren me shumicë votash të anëtarëve.
5. Anëtarët e Komisionit profesional të emëruar me këtë Vendim, do të kompensohen për punën e tyre. Kompensimi bëhet në vlerë prej 250€ (dyqind e pesëdhjetë eurosh) për secilin takim. Kompensimi i anëtarëve lejohet më së shumti për 4 (katër) mbledhje të mbajtura gjatë muajit.
6. Kushti për zbatimin e paragrafit 5. të këtij Vendimi, është zbatimi i procedurave të parapara me ligj, lidhur me angazhimin e anëtarëve të Komisionit profesional dhe ekzekutimin e shumës së pagesës.
7. Kompensimi i punës së anëtarëve të Komisionit profesional, bëhet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

8. Obligohet Komisioni profesional që brenda periudhës prej tre (3) muajsh, nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, t'ia paraqesë Qeverisë së Republikës së Kosovës rekomandimet lidhur me veprën artistike memoriale, si dhe rekomandimet e mëtejme në drejtim të zbatimit të projektit "Memoriali për Familjen Jashari dhe Epopenë e UÇK-së", në Bashkinë Hora e Arbëreshëve në Itali.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 16/280  
Datë: 19.12.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë euro), me qëllim të mbështetjes financiare për mbulimin e shpenzimeve të trajtimit mjekësor të veprimtarit të Republikës së Kosovës, z. Hafiz Gagica, i cili vuan nga një sëmundje e rëndë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nënprogramin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Thesari që të realizojë transferin e mjeteve sipas pikës 1. të këtij Vendimi në llogarinë bankare të caktuar nga z. Hafiz Gagica, sipas kërkesës së bashkangjitur të këtij Vendimi.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë